



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Zyra e personelit

Nr. Prot: 1/682
Datë: 11.6.2018

Në bazë të Nenit 12 pika 4 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149, si dhe Nenit 18 të Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil:

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" shpall

KONKURS

Për këto vende të lira pune me afat të caktuar në Universitetin Veror Ndërkombëtar të Prishtinës 2018 (UVNP):

1. Zyrtar i logjistikës (15 punonjës) - për periudhë 1 mujore, gjegjësisht prej: 21.6.2018 deri më datën 20.7.2018.

Kandidatët të cilët konkurrojnë për këto vende pune, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbyesit Civilë të Republikës së Kosovës, duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

Të kenë të kryer fakultetin ose të jenë studentë, të kenë aftësi të mira komunikimi, njohuri të punës me kompjuter, si dhe të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze.

Detyrat – përgjegjësitë:

- Verifikon dhe raporton listat e vijueshmërisë dhe performancës së studentëve;
- Furnizon profesorët me materiale të leximit;
- Furnizon klasat me orar;
- Distribuon dhe verifikon materialet për lexim të studentëve dhe profesorëve;
- Asiston në promovimin e kurseve, forumeve publike dhe aktivitetet tjera të UNVP-së;
- Përcjellë informata relevante për studentët dhe profesorët e UNVP-së;
- I asiston zyrtarit të projektit.

Konkursi mbetet i hapur **7 ditë** nga dita e shpalljes në web-in e UP-së, gjegjësisht deri më 17.06.2018. Në zbatim të nenit 11 pika 2 të Ligjit për Shërbyesit Civilë të Republikës së Kosovës, ftohen që të konkurrojnë edhe kandidatët nga komunitetet minoritare në Kosovë.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në **Rektoratin** e Universitetit të Prishtinës Rr. "George Bush", p.n. 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës, **zyra nr. 1**.

Aplikacionet për konkurrim mund të shkarkohen në: www.uni-pr.edu ose mund të merren me rastin e aplikimit për këto vende pune.

Në procedurën e pranimit të kandidatëve, do të bëhet intervistimi i kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet sipas konkursit.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë edhe numrin e telefonit kontaktues.

